



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, neneve 4 dhe 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019, Rregullores së Kuvendit të Komunës 15Nr.110/04-11057 e datës 28.02.2023 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 e datës 28.06.2019 si dhe nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 30.06.2026, pas shqyrtimit të propozim Vendimit mori këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR
FERMERË PËR SUBVENCIONIMIN E QUMËSHTIT

Neni 1

I ipet pëlqimi, Kryetarit të Komunës për marrjen e Vendimit për ndarjen mjeteve financiare në shumë prej **45,850.08**, (katërdhjetë e pesë mijë e tetëqind e pesëdhjetë euro e e tetë cent) për subvencionimin e qumështit për litër për 57 (pesëdhjetë e shtatë) fermerë të Komunës së Lipjanit me 0.04 cent për litër, të cilët kanë aplikuar sipas Thirrjes publike për aplikim të shpallur nga Drejtoratit për Bujqësi dhe Pylltari .

Neni 2

Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga të hyrat vetanake të Komunës, kategoria ekonomike - subvencione dhe transfere të planifikura për vitin 2026 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari, kodi i programit 47003, fondi burimor 21/613/47003/200/00000/0421.

Neni 3

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi dhe Pylltari dhe Drejtorati për Buxhet dhe Financa.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen elektronike të Komunës.

Nr. 15-400101-2936-3
Lipjan, më 30.06.2026

KUVENDI I KOMUNES LIPIJAN



Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi